



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**BORDI**

---

**V E N D I M**

**Nr. 26, datë 30.03.2017**

**MBI**

**FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2017**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E :**

Byroja Shqiptare e Sigurimit më datë 20.03.2017, ka depozituar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS-së, nr. 6, datë 20.03.2017.

Sipas këtij vendimi është propozuar krijimi i Fondit të Kompensimit për vitin 2017, i ndarë në dy komponentë:

- Shuma prej 468,000,000 lekë - për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit deri më datë 31.12.2013;
- Shuma minimale prej 105,000,000 lekë - për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit nga data 1 janar 2014 e në vazhdim.

Gjithashtu, Bordi i Autoritetit ka marrë Vendimin nr. 5, datë 03.02.2017, sipas të cilit është vendosur që Byroja Shqiptare e Sigurimit të marrë të gjitha masat e nevojshme, për shlyerjen e detyrimit të prapambetur brenda datës 31.03.2017. Vlera e prapambetur e përcaktuar në këtë vendim, është pjesë e detyrimeve për dëmet pezull të Fondit të Kompensimit dhe konsiderohet vlerë e shtuar e fondit të kompensimit të vitit 2017, si për dëmet me ngjarje sigurimi deri më datë 31.12.2013, ashtu dhe për ngjarjet e sigurimit pas 1 janar 2014.

Referuar informacionit të BSHS-së, rezulton se dëmet pezull të Fondit të Kompensimit për ngjarjet e sigurimit pas datës 1 janar 2014, e në vazhdim, janë në vlerën totale 157,042,463 lekë, siç propozohet në këtë vendim.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

### **V E N D O S I:**

1. Për vitin 2017, Fondi i Kompensimit për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull me datë ngjarje sigurimi deri në 31.12.2013, të jetë në vlerën 468.000.000 lekë, sipas pikës 2, të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit nr. 6, datë 20.03.2017.
  - 1.1 Byroja Shqiptare e Sigurimit të bëjë ndarjen e praktikave të dëmeve duke patur parasysh periudhën më të hershme të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
  - 1.2 Byroja Shqiptare e Sigurimit të shpërndajë menjëherë praktikat dhe të autorizojë për pagesë duke patur me prioritet praktikat me ngjarjet e sigurimit më të hershme.
2. Fondi i Kompensimit për vitin 2017, me qëllim pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, të jetë minimalisht në vlerën 157,042,463 lekë. Byroja Shqiptare e Sigurimit të bëjë ndarjen e praktikave të dëmeve te shoqëritë e sigurimit, si dhe të bëjë ndarjen e kësaj vlere sipas përcaktimeve të nenit 45, pika 2, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit të bëjë rakordimet për pagesat dhe detyrimet objekt i Fondit të Kompensimit, sipas pikës 2, të këtij vendimi çdo muaj.
4. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV**  
**Mimoza KAÇI**